

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-128/12

**Prishtinë
19 shkurt 2013**

Në çështjen juridike të

T. GJ.
R. B.5.
F.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala ankuese

kundër

P. B.
D.
K.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/150/2012 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA01118), të datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 19 shkurt 2013, morri këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohet sipas detyrës zyrtare vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/150/2012, i datës 29 prill 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA01118, dhe hedhet poshtë kërkesa pasi që ajo nuk bie në kuadër të juridiksionit të KKPK-së.
- 2- Pala ankuese duhet t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 € (gjashtëdhjetë) në buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 7 shtator 2007, P. B. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar kthimin në posedim të pronës që ndodhet në Ferizaj, Rexhep Bislimi 52, ngastra nr. 1131/2, një shtëpi me sipërfaqe prej 1 ar 69 m² dhe një oborr me sipërfaqe prej 4 ar 34 m² (në total prej 6 ar 03 m²). Ai ka deklaruar se uzurpuesi ishte T. Gj.i, dhe se kërkon kthimin në posedim si dhe kompensimin për shfrytëzim dhe dëmeve të shkaktuar në veçanti për shkatërrimin e furrës.

A ka paraqitur - përveç tjerash - fletën poseduese nr. 1222, zona kadastrale Ferizaj, që tregon se prona kontestuese ishte e regjistruar në emrin e P. (M.) B.. Fleta poseduese ka mund të verifikohet nga AKP-ja.

T. Gj. dha përgjigjen në kërkesë, duke thënë se në vitin 1981 ai e kishte blerë gjysmën e pronës. Pjesa tjetër ishte blerë nga paraqitësi i kërkesës. Ai i ofrojë AKP-së një kontratë shitblerjeje të pavërtetuar e datës 12 tetor 2005 sipas së cilës paraqitësi i kërkesës kishte shitur pjesën e tij të pronës për shumën prej 30.000 €.

P.B. u përgjigj, duke thënë si vijon: *“Po ju informoj se kjo është prona ime legjitime. Kështu, pronën e njëjtë ia kam dhënë me qira T. Gj.t, i cili e ka uzurpuar atë pas luftës dhe në ndërkohë e ka shkatërruar furrën e cila ishte pjesë e pronës së përmendur. I kam kërkuar që ta liroj pronën time por ai nuk e liroj. Meqë nuk e ka liruar, unë u obligova të iniciojë procedurën gjyqësore në mënyrë që organet kompetente do ta largonin nga prona. T.Gj. është pajtuar*

që ta paguajë qiranë, të cilën për ca kohë e ka paguar, por kohëve të fundit nuk e ka paguar qiranë”. Ai ka paraqitur një kërkesë, të cilën e kishte adresuar për Gjykatën Komunale në Ferizaj më 12 maj 2005. Në këtë kërkesë paraqitësi i kërkesës deklaroi si vijon: “paraqitësi i kërkesës për një kohë të gjatë kishte punuar përkohësisht në Gjermani, dhe gjatë qëndrimit të tij atje, ai ia kishte mundësuar, kumatit të tij T.Gj.të jetonte në këtë shtëpi së bashku me familjen e tij, ndërsa ta lironte atë sipas marrëveshjes”.

Më vendimin KPCC/D/R/150/2012 të datës 19 prill 2012, KKPK-ja e kishte miratuar kërkesën për vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe kthimin në posedim. Ndërsa hodhi poshtë kërkesën për kompensim, meqë Komisioni nuk kishte juridiksion ndaj kërkesave të tilla.

Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë më 1 tetor 2012.

Më 8 tetor 2012, pala përgjegjëse (këtej e tutje: pala ankuese) ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme. Ai ka kundërshtuar vendimin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Pala ankuese përsëriti deklaratimet e tjera para KKPK-së. Gjithashtu, ai e informojë Gjykatën se kishte iniciuar procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Ferizaj, për të shqiptuar masa të përkohshme ndaj kumatit të tij [këtej e tutje: pala përgjegjëse në ankesë]. Sipas deklaratimeve në këtë kërkesë, pala ankuese ka të drejtën e pronësisë për ½ e pronës, të cilën e ka në posedim që nga viti 1982. Pala përgjegjëse në ankesë e kishte regjistruar pronën në emër të tij pa dijeninë e palës ankuese. Aktualisht, pala përgjegjëse në ankesë, po mundohet ta shes pronën, përfshirë edhe pjesën e palës ankuese.

Pala ankuese nuk dha përgjigje në ankesë.

Arsyetim ligjor

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të paraparë në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Ankesa, po ashtu është e suksesshme meqë kërkesa nuk ka mundur të miratohet. Rasti nuk është në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të KKPK-së (neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079), ky vendim ankimor duhet të anulohet sipas detyrës zyrtare dhe në vend se të miratohet kërkesa, ajo duhet të hedhet poshtë.

Ndonëse KKKP-ja si organi kuazi gjyqësor duke vendosur mbi meritat e kërkesës tashmë e ka pranuar juridiksionin e tij, gjykata vlerëson sipas detyrës zyrtare nëse lënda bie në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të tij (neni 195.1 b) i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore).

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon të drejtën ndaj pronësore por edhe që ai apo ajo nuk kanë qenë në gjendje t'i ushtrojnë të drejtat e këtylla pronësore për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti ndërliken apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Megjithatë, në këtë rast, pala përgjegjëse në ankesë nuk ka dëshmuar e as që ka dhënë indikacione të mjaftueshme se humbja e pronës ka ndonjë lidhje me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999. Në të kundërtën, vetë pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se ai ia kishte dhënë banesën kumatit të tij që të jetojë në të për ca kohë. Se pala ankuese vetëm ka qëndruar në banesë dhe tani e deklaroi banesën si të vetën, në asnjë aspekt nuk ndërliken me konfliktin e armatosur të vitit 1998/1999

Rastet si këto nuk janë në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të KKKP-së apo të Kolegjit të Apelit të AKP-së, ato duhet të gjykohen nga gjykatat e përgjithshme kompetente civile.

Prandaj, vendimi i KKKP-së lidhur me kërkesën duhet të anulohet sipas detyrës zyrtare dhe kërkesa duhet të hedhet poshtë në mungesë të juridiksionit të KKKP-së dhe gjykatës.

Ky vendim i gjykatës nuk paragjykon të drejtën e palës përgjegjëse në ankesë që të kërkojë konfirmimin e së drejtës së saj pronësore para autoriteteve kompetente vendore.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të UA 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet mbi 20.000 € : 30 €.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala përgjegjëse në ankesë që humb rastin. Në përputhje me nenin 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është 15 ditë. Neni 47, paragrafi 3 parashih që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së taksave. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta ose të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it